# DËSHMI ARKIVI

**A-455913**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Lehtësohen procedurat për pronat dhe oborret, trajtim "në bllok" dhe zero kosto për legalizimin e ndërtimeve |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sociale/lehtesohen-procedurat-per-pronat-dhe-oborret-trajtim-ne-bllok-dhe-zero-k-i586943` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 16:46:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 17:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | d05b8c9bf468ddab4d612649e4182e195bb2c8e74196e1d6c0101b709a85eb14 |
| TEKSTI | 079b5b09e6b0239fe3a7d40940d8ec022c028d83d10e53b2e054477ca8448497 |
| PAMJA | 55d91e4d18a21669bcd28e307dcf0674625bfab5cfad2d2cdcbf0b21b715abce |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 4e7c7eb9f023d2dbdd35e3ed7a7aeff9f8013ed2c57cfc1c0a8aa72fb0e54ff0 |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4e7c7eb9f023d2dbdd35e3ed7a7aeff9f8013ed2c57cfc1c0a8aa72fb0e54ff0`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Lehtësohen procedurat për pronat dhe oborret, trajtim "në bllok" dhe zero kosto për legalizimin e ndërtimeve

TemA

18 Shtator 2026, 19:40Sociale TEMA



Procesi i pajisjes me titull pronësie për ndërtimet pa titull, trojet funksionale dhe oborret në përdorim do të zhvillohet përmes procedurave më të lehtësuara dhe me më pak kosto për qytetarët. Ndryshimet e reja në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 827/2020, të cilat tashmë kanë hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, synojnë përshpejtimin e formalizimit dhe rritjen e sigurisë juridike.

Sipas Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), një nga risitë kryesore është mundësia e trajtimit të pasurive "në bllok", sipas blloqeve kadastrale. Kjo metodë do të lehtësojë kryerjen e verifikimeve në terren për disa pasuri njëkohësisht, duke shkurtuar ndjeshëm kohëzgjatjen e procedurave administrative.

**Heqja e tarifave dhe lehtësimi i kostove**

Përveç përshpejtimit procedural, ndryshimet e reja sjellin edhe lehtësim financiar për qytetarët. Në rastet kur procedura e formalizimit nis kryesisht nga vetë ASHK-ja, për objektet me funksion banimi nuk do të aplikohet tarifa standarde e shërbimit:

Fshihet tarifa prej 3,000 lekësh për ndërtimet pa leje;

Fshihet tarifa prej 10,000 lekësh për objektet pa titull, trojet funksionale dhe oborret në përdorim.

**Trojet deri në 300 m² dhe ndërtimet para vitit 1991**

Ndryshimet përcaktojnë gjithashtu rregulla më të qarta lidhur me sipërfaqet e trojeve funksionale dhe oborreve në përdorim për ndërtimet e ngritura përpara vitit 1991.

Miratimi i dokumentit të pronësisë për sipërfaqen e truallit funksional deri në 300 m² do të bëhet falas në rastet kur trualli është në pronësi shtetërore, figuron

me pronar të pavërtetuar ose kur nuk ka informacion mbi pronësinë, pavarësisht nëse në këtë sipërfaqe ka edhe ndërtime pa leje që lidhen me vetë subjektin. Përcaktimi i kësaj sipërfaqeje do të bëhet duke marrë në konsideratë nevojat reale të ndërtimit dhe kuadrin ligjor që ka qenë në fuqi në kohën e ndërtimit.

Përmes një njoftimi në rrjetet sociale, Kadastra Shqiptare konfirmoi se qëllimi kryesor i këtyre ndryshimeve mbetet përshpejtimi i formalizimit të pronës, lehtësimi i burokracisë dhe garantimi i të drejtave pronësore për qytetarët.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Do thoni në djall ato që fituam”, Rama paralajmëron supermarketet, kërkon transparencë për çmimet (VIDEO)]

16:20 Sociale / 17 komente

[Shqipëri–Slloveni, rritet bashkëpunimi ekonomik - Turizmi malor dhe përpunimi i drurit në fokus të diskutimeve për investime dhe partneritete të reja]

16:10 Sociale

Kontroll agjencive funerale në Tiranë, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara

15:50 Sociale / 4 komente

[Ilirjan Celibashi kërcënon me mesazhe gazetaren Desada Metaj, reagon AGSH]

15:06 Sociale / 21 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.